




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <b>2-D/2-Prerok</b>	Nr Prot. Br Prot Prot No <b>01-1356/15</b>
Nr. f. pag. B. e. s. t. m. i. c. a Nr. pages <b>02</b>	Date Datum <b>18-05-2015</b>
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.05.2015, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti** me nr. AKK– 03 – 02-476/15, për **z. Besnik Berisha**, për shkak se zyrtari i lartë publik ka dhënë dorëheqje nga funksioni i **Këshilltarit për Çështje të Drejtësisë në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës**. Me këtë ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

**II. Rasti mund të rihapet** në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik**, nr. AKK – 03 – 02 - 476/15, për zyrtarin e lartë Besnik Berisha – Këshilltar për Çështje të Drejtësisë në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

z. Berisha është hetuar për konflikt interesi për shkak se, krahas ushtrimit të funksionit të zyrtarit të lartë publik, ka ushtruar funksionin e avokatit, si dhe ka qenë person i autorizuar në bizneset private N.Sh. “Balkan International”, Kompania e Sigurimit Fizik “KS Guards” Sh.P.K. dhe “Besnik R. Berisha & Associates” L.L.C.

Në trajtimin e këtij rasti, fillimisht, Agjencia kundër Korrupsionit (AKK) i ka dërguar z. Berisha shkresën zyrtare, njoftim për fillimin e procedurës për shqyrtimin e konfliktit të interesit, pas së cilës ai është paraqitur në takim në zyrat e AKK-së.

z. Berisha është bindur për kufizimet në ushtrimin e funksioneve tjera krahas ushtrimit të funksionit të zyrtarit të lartë dhe ka premtuar që, në afatin ligjor, do ta shmang konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, të lëshuar nga Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, me të cilën vërtetohet se i ka pushuar mandati i Këshilltarit Politik të Kryeministrit. Me këtë z. Berisha ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

**II.** Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).



Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni